



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranimi / Dorezuar Priljevoj / Predato Received / Delivery	14.06.2022	2	viti god year
Organ / Agjencia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMŠHCK	3473/2022		113



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.436/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.436/2022 të datës 04.05.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi kundër organit të punësimit/ Agjencia Pyjore e Kosovës, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5, neni 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 14.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.436/2022 e datës 04.05.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në pozitën Zyrtar për çështje ekonomike sipas Akt emërimit të datës 31.01.2012 në Agjencinë Pyjore të Kosovës përmes e-mailit ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila më datë 04.05.2022 është pranuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe është regjistruar me numër të ankesës A.nr.436/2022 dhe Nr. Prot: 2566/2022, me pretendimet ankimore për kompensimin e pushimit vjetor të mbetura për vitin 2020 dhe 2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitave Rregullore Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 11.05.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Agjencinë Pyjore të Kosovës, ndërsa Këshilli ka pranuar shkresat e lëndës nga organi i punësimit me datën 17.05.2022 me numër protokollit 2866/2022..



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot.:2566/2022 të datës 04.05.2022 e parashtruar nga ankuesi përmes e-mailit zyrtar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail zyrtar i datës 29.04.2022; Vendimi i datës 03.02.2022 me numër protokolli 377; Vendimi i Komisionit Disiplinor i datës 13.03.2020 me numër 1241 i Agjencisë Pyjore të Kosovës; Kërkesë e datës 19.04.2022 me nr.1517 për shfrytëzimin e pushimit vjetor për vitin 2021 para datës 30 qershor 2022; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 17.05.2022 me numër protokolli 2866 /2022 bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/14; Akt emërimi i datës 31.01.2012 ; E-mail zyrtar i datës 29.04.2022; Njoftim i datës 06.04.2020; E-mail zyrtar i datës 07.04.2022; Largim nga lista e pagave e datës 01.04.2020; lista e pagave për muajin mars 2020 dhe Kërkesa e datës 20.04.2020

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, **refuzohet si e pabazuar, sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave të lëndës të pranuar nga ankuesi dhe organi i punësimit ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit për kompensimin e pushimit vjetor që nga data 18.03.2020 deri më datën 03.02.2022 , pasi që i njëjti ka pasur shkëputje nga puna, ka konstatuar se ky pretendim i ankuesit është i paqëndrueshëm.

Ankuesit me datën 13.12.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Agjencisë Pyjore të Kosovës për shkak të shqiptimit të masës disiplinore- ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Këshilli me datën 14.01.2022 ka nxjerrë vendimin me numër protokolli 169/2022 me të cilin ka aprovuar ankesën e ankuesit dhe ka obliguar organin e punësimit që ta kthejë ankuesin në vendin e punës sipas akt emërimit të datës 31.01.2012 në pozitën Zyrtar për çështje ekonomike në Drejtorinë Koordinuese në Agjencinë Pyjore të Kosovës-Gjilan.

Ankuesi me datë 19.04.2022 ka parashtruar kërkesë me nr.1517 për Drejtorin për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme në Agjencinë Pyjore të Kosovës për shfrytëzimin e gjithë pushimit vjetor për vitin 2021 para datës 12 qershor 2022. Me datë 29.04.2022 Menagjerja e Njësisë së Burimeve Njerëzore i është përgjigjur ankuesit e cila thotë se ankuesi në vitin 2021 nuk e ka pas asnjë ditë pune dhe kërkesa për realizimin e kompensimit të pushimit vjetor për vitin 2021 është e parealizueshme.

Sa i përket pretendimeve ankimore të ankuesit për kompensimin e ditëve të pushimit vjetor të pashfrytëzuara për periudhën 18.03.2020 deri më datën 03.02.2022, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave , konstaton që neni 39 paragrafi 7 i Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se :**"Pushimi vjetor nuk mund të shndërrohet në formë tjetër kompensimi monetar ose jo monetar"**, mbi bazë të kësaj neni 5 paragrafi 8 i Rregullores Nr.06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civil , ku përcaktohet se : **"8. Në rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës në Shërbimi Civil, nëpunësi civil kompensohet me pagesë të kalkuluar për ditët e pashfrytëzuara të pushimit vjetor. Në rastin e kundërt, nëse ditët e pushimit vjetor janë shfrytëzuar para kohës së fitimit të drejtës për pushim, atëherë nga paga e fundit bëhen ndalesat e kalkuluara për ditët e fituara"**. Bazuar në këtë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave , konstaton se nëse i referohemi Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht neni 18 paragrafi 4 përcaktohet se **"Pushimet e zyrtarëve publikë rregullohen sipas legjislacionit të punës"**, ndërsa sipas Ligjit Nr.03/L-212 i Punës, konkretisht nenit 32 paragrafi 5 , përcaktohet se: 5.



“Ditët e pashfrytëzuara të pushimit vjetor nuk mund të kompensohen me para, përjashtimisht kjo mund të bëhet kur marrëdhënia e punës i skadon të punësuarit”. Andaj meqenëse ankuesit nuk i ka skaduar marrëdhënia e punës, atëherë nuk mund të bëhet kompensimi në rastet e tilla, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.


Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.436/2022, datë 14/06/2022

Sabile AVDYLI


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit,
- ❖ Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës;
- ❖ Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Pyjore të Kosovës dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

